

E nderuara Ambasadore Apostolova,

I nderuar Minister Hamza,

I nderuar z. Taylor,

Të nderuar përfaqësues të insitucioneve vendore dhe ndërkombëtare,

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë e veçantë të marrë pjesë në prezantimin e “Raportit të Tranzicionit për vitin 2019” që njëkohësisht shënon edhe 12 vjetorin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Rëndësi të veçantë ka fakti se raporti i këtij viti për fokus kryesor ka temën e qeverisjes korporative, për të cilën Banka Qendrore ka demonstruar leadership përtej mandatit të saj, ku në rolin e Rregullatorit dhe Mbikëqyrësit të Institucioneve Financiare në Republikën e Kosovës ka avancuar kërkesat për qeverisje më të mirë korporative. Më lejoni fillimisht të ndaj me ju disa pikëpamje lidhur me rëndësinë që qeverisja korporative ka për sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi. Financat në përgjithësi dhe bankingu në veçanti kanë të bëjnë thjeshtë me besueshmërinë, kjo sidomos është e evidente për vendet me përvojë jo të gjatë me produkte financiare, institucione dhe tregje financiare të zhvilluara. Kriza e fundit financiare tregoi se një prej shkaqeve kryesore të krizës mund t’i atribuohet dobësive në qeverisjen korporative. Shumë studime të bëra deri më tani konfirmojnë lidhshmërinë e fortë të qeverisjes korporative me performancën e këtyre bankave gjatë krizës financiare.

Tani, më shumë se një dekadë pas krizës së fundit financiare, sektori financiar i Kosovës ka arritur të tejkalojë pa problem disa nga sfidat me të cilat u ballafaquan vendet tjera. Sidoqoftë, ne kemi shfrytëzuar këtë moment në vazhdimin e ndërtimit të një mjedisi financiar edhe më të qëndrueshëm dhe më stabil, shtyllë e të cilit janë parimet dhe standardet më të mira të qeverisjes korporative.

Mesazhi ynë për sektorin financiar ka qenë shumë i qartë: krahas nevojës për qartësi më të madhe në strukturën organizative, ndarje të përgjegjësive dhe rritje të kompetencës profesionale, kërkohet mënyrë e re e të menduarit nga ana e bordeve të tyre me fokus të veçantë:

- Në ngritjen e kapacitetit kolektiv për identifikimin e rreziqeve;
- Fokusim tek qëndrueshmëria afatgjate ekonomike e institucioneve financiare;
- Adaptimin e një modeli të qeverisjes korporative që shton vlerë të ndërtuar mbi mekanizmat e organizimit efektiv të një institucioni financiar (d.m.th., kulturën, modelin e biznesit, madhësinë, nevojat organizative, etj.), dhe
- Mbi të gjitha adaptimin e një modeli që siguron transparencë, paañesi dhe trajtim të barabartë të të gjitha palëve me interes (aksionarët, klientët dhe punëtorët).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operacionale dhe si e tillë adapton një qeverisje korporative moderne jo vetëm të organizimit të brendshëm por edhe të kërkesave rregullative që kemi në raport me institucionet financiare që ne i mbikëqyrim. Këtë pavarësi BQK-ja e domostron me llogaridhënie dhe transparencë të fuqishme si një mekanizëm i rëndësisë së veçantë i qeverisjes së mirëfilltë korporative.

Kohëve të fundit keni qenë dëshmitarë të disa vendimeve të marra nga BQK-ja në raport me institucionet financiare që kanë rrezikuar stabilitetin e sektorit financiar në Kosovë dhe nuk kanë qenë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Kjo flet për vendosshmërinë e Bankës Qendrore për të ushtruar mandatin e saj kushtetues, dhe të qeveriset nga rregullat dhe standardet më të mira të qeverisjes korporative. Ne do të vazhdojmë të mbesim të paluhatur në veprimet tona që ekonomisë së Kosovës t'i ofrojmë institucione financiare dhe burime të financimit, që u përshatet nevojave zhvillimore dhe stabilitetit të ekonomisë.

Ashtu siç theksova edhe më lart, angazhimi i BQK-së në avancimin e agjendës së Qeverisjes Korporative në Kosovë është shumë dimensional. Funksionimi mbi baza të një qeverisje korporative moderne na ka mundësuar që të zhvillojmë me sukses kornizën ligjore të qeverisjes korporative edhe për institucionet financiare në Kosovë. Kërkesat për qeverisje korporative të avancuar që kanë dalë nga kjo kornizë jo vetëm që kanë ndikuar në implementimin e modeleve të mirëfillta të qeverisjes nga institucionet financiare, por të njëjtat t'i transferojnë edhe në sektorin privat përmes kompanive që ato i kanë financuar duke kërkuar mekanizma më të mirë të menaxhimit të rrezikut, kontrollave të brendshme, shpalosjes dhe transparencës.

Banka Qendrore ka luajtur rol kritik edhe në instalimin e mekanizmave modernë të qeverisjes korporative në dy institucione të rëndësishme të veçantë për ekonominë e Kosovës; Fondin për Sigurimin e Depozitave në Kosovë dhe Fondin për Garantimin e Kredive në Kosovë.

Në këtë rrugëtim prej dy dekadave, Banka Qendrore dhe institucionet tjera vendore në Kosovë kanë gëzuar privilegjin për t'u përkrahur dhe këshilluar nga shumë

Institucione ndërkombëtare financiare, përfshirë këtu FMN, USAID, Thesarin Amerikan, Bankën Botërore, KFW, GIZ, BERZH dhe të tjera. Në veçanti kontribut në fushën e qeverisjes korporative në Kosovë ka nikoqiri ynë sot, Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim, jo vetëm duke qenë investitor aktiv në sektorin privat dhe atë financiar, por edhe duke ndihmuar akterët në këta dy sektorë dhe institucionet tjera me asistencë teknike për avancimin e praktikave të qeverisjes korproative në mënyre shumë kualitative.

Përkushtimin e BERZH-it në këtë drejtim e tregon edhe publikimi i fundit i Raportit të Tranzicionit me moton “Qeverisje të mirë për Ekonomi më të mirë”. Ky raport nxjerr në pah faktin se Kosova ka avancuar më shumë se vendet tjera në aspektin e qeverisjes korporative, megjithatë vlerësoj se ende nuk kemi arritur të integrojmë qeverisjen e mirë korporative thellësisht dhe me një gjithëpërfshirje institucionale. Prandaj, ne duhet të vazhdojmë që të gjitha përpjekjet tona të jenë të përqendruara në këtë drejtim në mënyrë që të pozicionojmë Kosovën në nivel konkurrues në tregjet regjionale dhe evropiane dhe vetëm atëherë Kosovën do të mund ta prezantojmë ekonominë e saj në një cikël të rritjes së produktivitetit dhe rritjes së përshpejtuar ekonomike.

Më lejoni ta përmbyll këtë adresim me premisën e **besimit** mbi bazën e të cilit funksionon sektori financiar. Rrjedhimisht, për të fituar besueshmërinë në tregun financiar duhet të kemi institucione të besueshme, ndërsa institucionet në esencë janë njerëzit të cilët i ndërtojnë dhe menaxhojnë ato. Prandaj, aksionarë aktivë, borde efektive, menaxhment adekuat, konsumatorë (huamarrës dhe depozitor) të përgjegjshëm dhe institucione të mirëfillta janë faktorët kryesorë të qeverisjes korporative kualitative.

Në fund, dëshiroj ta përgëzoj BERZH-in për një raport të shkëlqyeshëm që në fakt mbi të gjitha na përkujton sfidat që na presin në rrugëtimin tonë drejt zhvillimit të mëtutjeshëm.

Ju faleminderit!